A.K.P.A.
Nr 3024 Prot.
Datë,më 12.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE ELBASAN

Nr. 491/6 prot. Elbasan, më 11.11.2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, të udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë, menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimin e vazhduar profesional të personelit, përbërjen e njësisë së zhvillimit, të institucioneve ofruesve të arsimit dhe formimit profesional", i ndryshuar:

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Elbasan, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin mësimdhënës i kulturës profesionale.

- Pozicioni: mësimdhënës i teorisë profesionale **në drejtimin Termo-hidraulikë** nje mesues.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriterete përgjithshme si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së; preferohet ing. Hidroteknik
b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 19.11.2026.

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024,"Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë, menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimin e vazhduar profesional të personelit, përbërjen e njësisë së zhvillimit, të institucioneve ofruesve të arsimit dhe formimit profesional", i ndryshuar.

DREJTOR
LEONIDHA HAXHINIKOLLA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE SHKOLLORE E PROFESIONALE ELBASAN